

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në mbështetje të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41. /2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft me seli në Porsheplatz 1, D-70435 Shtuttgart, Gjermani, i dorëzuar përmes personit të autorizuar Bozhidar Millosheviq, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 31.07.2024, solli:

AKTVENDIM

1.Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft me seli në Porsheplatz 1, D-70435 Shtuttgart, Gjermani, do të fitojë kontroll të pavarur mbi biznesin dhe mjetet që përbëjnë biznesin si tregtar i autorizuar i automjeteve motorike i operuar nga Xhardin Specialist Kars Ltd. me zyrën e saj të regjistruar në Loksl Haus 2 Oukvud Kort, Litl Ouk DraJV, Ansl, Notingam, Angli, NG15 ODR, Mbretëria e Bashkuar, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2. Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbartimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 03.08.2023, dhe e plotësuar më 25.06.2024, e plotësuar më 03.07.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar njoftim i përqendrimit nga Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft me seli në Porsheplatz 1, D-70435 Shtuttgart, Gjermani, me të cilin Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaftdo të fitojë kontroll të pavarur mbi biznesin dhe mjetet që përbëjnë biznesin si tregtar i autorizuar i automjeteve motorike i operuar nga Xhardin Specialist Kars Ltd. me zyrën e saj të regjistruar në Loksl Haus 2 Oukvud Kort, Litl Ouk DraJV, Ansl, Notingam, Angli, NG15 ODR, Mbretëria e Bashkuar.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

-**Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft** është një prodhues gjerman i automobilave dhe pjesë e Grupit Volkswagen, i specializuar në makina sportive, SUV me performancë të lartë.

Grupi Volkswagen është aktiv në mbarë botën me zhvillimin, prodhimin, marketingun, dhe shitjen e makinave të pasagjereve, kamionëve të lehtë komercial, autobusëve transportues(coaches), shasi për autobusë dhe motorëve me naftë, motoçikletave, përfshi pjesë rezervë dhe pajisje shtesë. Grupi Volkswagen është gjithashtu i përfshirë në shpërndarjen e automjeteve. Grupi Volkswagen përshin markat e automjeteve motorike Volkswagen Passenger Cars, Volkswagen Light Commercial, Porsche, Audi, Škoda, Lamborghini, SEAT, MAN, Scania dhe Ducati. Grupi Volkswagen ofron gjithashtu zgjidhje për shërbimet e lëvizshmërisë, siç janë makinat me thirrje dhe ndarje të makinave.

Përveç kësaj, Grupi Volkswagen ofron shërbime financiare dhe sigurimesh në lidhje me shpërndarjen dhe financimin e makinave dhe automjeteve të tij komerciale.

Grupi Volkswagen është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të varura të mëposhtme:

-Porshe Lizing SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup dhe me aktivitet prioritar të regjistruar - lizing financiar;

- Porshe Broker SHA Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup dhe me aktivitet prioritar të regjistruar - aktivitetet e përfaqësuesve të sigurimeve dhe ndërmjetësve të sigurimeve;

- Skania Macedonia SHPKNJP Ilinden, me seli në rr. 34 nr. 7 Ilinden, Shkup dhe me një aktivitet prioritar të regjistruar - tregtia bëhet mjete motorike dhe

- Porshe Macedonia SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnjë dhe Hercegovinë nr. 4, Shkup dhe me një aktivitet prioritar të regjistruar - tregtia e makinave dhe mjeteve motorike me peshë të lehtë.

-**Biznesi i synuar** përbëhet nga operacionet e biznesit dhe mjetet e PC Londra e Jugut,, e cila filloi operimet në janar 2018, dhe PC Londra Lindore, e cila nga ana tjetër filloi operimet në prill 2015. Biznesi i synuar aktualisht është në pronësi dhe operuar nga Xhardin Specialist Kars Ltd. PC Londra e Jugut dhe PC Londra Lindore janë aktualisht shitës të pavarur të Porshe që operojnë në tre fushat e mëposhtme të biznesit:

- Shpërndarja me pakicë dhe shitja e të gjitha llojeve të makinave Porshe të reja dhe të përdorura (automjete sportive dhe të terrenit);

- Ofrimi i shërbimeve të lehta të riparimit dhe mirëmbajtjes për të gjitha llojet e makinave Porshe dhe

- Shpërndarja me pakicë e pjesëve rezervë origjinale të Porsche, veçanërisht për makinat Porsche Classic. Porsche Classic i referohet automjeteve retro që nuk janë prodhuar rregullisht për të paktën 10 vjet.

Biznesi i synuar nuk është i pranishëm dhe nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска